



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 106/ 2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër Xhevat Jakaj anëtarë i subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, për shkak të ndikimit tek votuesit gjatë ditës së zgjedhjeve, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 03.05. 2012, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 30.04.2012, nga subjekti politik PDK, dega në Ferizaj, me të cilën pretendohet se me datën 29.04.2012 ditën e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar komune në Ferizaj, në Vendvotimin (VV) e fshatit Surqin, ka qëndruar një periudhë të gjatë prej orës 13:00 deri në ora 15:30 edhe pse policia disa herë ia ka tërhequr vërejtjen ai nuk është larguar nga oborri i shkollës në të cilin ka qenë Qendër e Votimit (QV) duke bërë fushatë para votuesve dhe duke i shtyrë ata që të votojnë subjektin e tij, parashtruesi i thekson se është bërë shkelje të ligjit zgjedhor dhe kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre.

Me datën 01.05.2012 PZAP-i kërkoi nga Policia e Kosovës që të ndërmarr masa hetimore për rastin në fjalë.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

Ankesa është e pabazuar.

Pala ankuesi pretendon se në VV e fshatit Surqin, ka qëndruar një person me emrin Xhevati Jakaj nga ora 13:00 deri 15:30 më datën 29.04.2012, duke bërë fushatë para votuesve. Ndërsa në raportin e policisë të datës 02.05.2012, të përgatitur nga policët hetues theksohet se me datën 29.04.2012, deri sa kanë qëndruar në QV në shkollën fillore "Liman Rekaj" gjithçka ka qenë në rregull, diku rrëth orës 15:00, përgjegjësi për mbarëvajtjen e kësaj QV, drejtori i shkollës ka kërkuar nga policët që ti largojnë personat të cilët nuk janë të autorizuar zyrtarisht në atë QV dhe që nuk posedojnë bëxh identifikimi të largohen nga oborri i shkollës, në atë moment kur drejtori i shkollës ka kërkuar që të largohen ata persona aty para shkollës ka qen një person nga fshati Prelez me emrin Xhevati Jakaj, ne kemi kërkuar nga ai që të largohet nga oborri i shkollës dhe ai është larguar nga aty.

PZAP-i, duke u bazuar në raportin e policisë si dhe nga shkresat e lëndës gjeti se pretendimet ankimore në ankesë nuk qëndrojnë përfaktive se nuk janë dhënë prova apo dëshmi relevante për cilat pretendohet në ankesë, andaj një pretendim i tillë i ankesës u vlerësua si i pa bazë dhe i pa argumentuar.

Prandaj në kuptim të nenit 115.1 lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në diapozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkeshat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshire është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesë dhe Parashtresë

A nr. 106/2012 më datën 03.05.2012.

